

HYRJE

Trafikimi i grave dhe i fëmijëve përbën një dhunë të rëndë në dëm të tyre dhe një dhunim të drejtave themelore të tyre. Ky fenomen është në rritje në shumë pjesë të botës. Anëtarët e Grupeve të Punës mbi trafikun e grave dhe të fëmijëve janë ndërgjegjësuar mbi problemet me përvojat e drejtpërdrejta dhe ndërmjet kontakteve me rregulltarët e tjerë që merren me gratë dhe fëmijët e trafikuar. Kemi ndier një nevojë të urgjentë për të mobilizuar rregulltarët e të gjithë botës të angazhuar në zonën e parandalimit, të riabilitimit dhe të veprimit politik. Shpresojmë që ky material të shërbejë në ngritjen e pyetjeve të trafikimit ndërmjet kongregatave rregulltare të meshkujve dhe femrave, mes grupeve famullitare dhe mes rrjeteve të organizatave jo qeveritare që bashkëpunojnë me urdhërat rregulltarë.

Ky material furnizon një kalim të problemeve kryesore lidhur me trafikun e grave dhe të fëmijëve dhe përvijon disa mundësi strategjike për kongregatat rregulltare, deri sa të ndërveprojnë mes tyre dhe me organizatave të tjera për të luftuar trafikimin. Ofron ndër të tjera:

- Mundësinë që të dalë në pah ky problem serioz dhe urgjent;
- Informacione specifike të marra nga dokumentat zyrtare të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë një botim kolektiv nga UNIFEM, nga UNDP dhe nga SEAwatch¹; lidhje dhe artikuj të ofruar nga disa organizata që merren me trafikimin;
- Nismat e reflektimit teologjik;
- Ide për një laborator në fund të çdo seksioni dhe në një shtesë të veçantë.

Grupi i Punës shpreson që ky material të mund të jetë katalizatori për thellime të mëtejshme në nivel vendor, kombëtar dhe global.

¹ UNIFEM East and South-East Asia, Trafficking in Women and Children. Mekong Sub-Region, 23 September 1998 (Mund të gjendet në <http://unifem-eseasia.org/Resources/Traffick2.html>). UNIFEM (Fondi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë). UNDP (Progami i zhvillimit të Kombeve të Bashkuara), SEAwatch (Vrojtuesi i Azisë Jug-Lindje).

Kush janë viktimat e trafikimit? Çfarë është trafikimi? Histori të atyre që kanë jetuar këtë përvojë.

Historitë që ndjekin janë treguar nga gratë viktime të trafikut ose nga persona që japin mbështetjen e tyre. Ndërsa lexoni çdo tregim:

1. Futuni në kontekst sa më shumë që të mundeni.
2. Kërkoni se cilat lloje dhe kushte janë në orgjinë të trafikut .
3. Pasi ta keni njohur këtë gjendje provoni të jepni një përcaktim mbi trafikun.

a- Ja historia e Lenës

Nuk mund të përdorni emrin tim të vërtet, dhe as atë që më kanë dhënë në Kinë. Nuk e di as se cili duhet të jetë emri im i vërtet. Nuk jam më i njëjti person që dy vjet më parë kur kam lënë fshatin tim. Trupi im është kthyer por shpirti im është në ndonjë vend tjetër .

Asnjë nuk më njeh më, dhe kushdo që vjen për të më takuar... besoj se e bën për të më parë, tani që jam e ndyrë. Brenda jam e papastër dhe shpirti im është zbrasur. Nuk e di a do mund të jetoj në këto kushte. Mamaja ime vjen në dhomën time dhe më thotë: "Lena, një herë e një kohë ishe një person kaq miqësor. Më mungon Lena e asaj kohe". Dhe unë i përgjigjem: "Mama, tani jam ndryshe. Ka vdekur diçka brenda meje. Mendoj se ka vdekur lumturia ime".



Nuk do ta kisha menduar kurrë që një gjë e fillë do të më ndodhte mua. Isha 16-vjeç kur erdhën në fshat. Dukeshin shumë të sjellshëm dhe u kanë ofruar vajzave një punë si kuzhinierë në Kinë. Oferta ishte shumë joshëse: tri muaj shkollë kuzhine me shpenzime të paguara dhe punë të garantuar në një hotel luksoz kinez për një vit. Kam firmosur një kontratë së bashku me nëntë vajza të tjera. Ata nuk na dhanë kohë që ta lexonim ose t'ua tregonim prindërve tanë. Mendoja se prindërit tanë duhet të firmosnin ata dokumenta sepse ne shkonim akoma në shkollë. Por ata nxitonin, kështu që ne firmosëm kontratat për të mos e humbur atë rast.

Ishim shumë të emocionuara kur morëm biletat dhe pashaportat për Kinë dhe ato persona aq të sjellshëm që kishin ardhur në fshat na shoqëruan deri tek avioni. Familjet tona menduan se do të fitonim shumë para dhe se do të ishim në gjendje t'i ndihmonim ekonomikisht. Por më vonë gjithçka ndryshoi. Gjatë udhëtimit, shoqëruesit tanë na kanë trajtuar sikur të ishim kriminele. Në Kinë kanë djegur pashaportat tona. Masha u mundua të ngrinte kryet, por ata e rrahën dhe e dhunuan përpara nesh. Nuk kishte as shkollë kuzhine dhe as vende pune, por vetëm një shtëpi publike (bordello). Në Kinë, ditën e parë na çuan në morg për të na treguar trupat e dy vajzave që ishin munduar të largoheshin duke u hedhur poshtë nga dritarja. Na thanë që nuk kishte rrugëdalje për ne deri sa të kthenim borxhet për biletat dhe shpenzimet e tjera duke punuar si prostituta. Por më pas mbajtën paratë.

Unë jam përsëri në shtëpi sepse pas gjashtë muaj policia bëri një sulm në shtëpinë tonë publike dhe më riatdhesuan. Mund të mendoni që kam qenë me fat, por nuk është kështu. Herët a vonë, do të kthehen të më kërkojnë dhe nëse nuk do t'i ndjek do të më vrasin mua dhe ndoshta edhe familjen time. Kur ata vijnë në fshat dhe ti firmos kontraten gjithçka merr fund. Unë kisha dëshirë të bëhesha mësuese.

(<http://www.miramedinstitute.org/lena.html>).

b- Ja historia e disa grave nigeriane?

Nigerianet, viktimat e trafikimit janë shumë të reja, të moshës prej 16 deri 22 vjeç. Niveli i tyre i edukimit shkollor arrin, më e larta, në atë filllore. Pjesa më e madhe e tyre janë beqare, por shtohen rastet e grave të martuara.

Hapi i parë: trafikantët fusin në kurth vajza të reja

Vajzat dhe gratë që mund të futen të kurth, ose të cilave mund t'u interesojë emigrimi, kontaktohen - dhe më pas binden nga trafikantët - në periferi (shtëpitë barake përreth qyteteve të mëdha) ose në zonat rurale. Zakonisht është një grua më e madhe që fut në kurth vajzat, që quhet *madam* ose *Mama Loa* (domethënë "priftëresha"). Pikërisht pjesëmarrja e këtyre grave, detyra e të cilave është që të dallojë dhe të bindë të rejat e reja të zgjedhura, përbën një mekanizëm të posaçëm të trafikimit që i përket Nigerisë. I mbarë procesi është zotëruar nga madam sepse ajo ushtron pushtetin e saj kulturor si formë të bashkëushtimit jo fizik mbi viktimat e trafikimit. Roli i grave është i rëndësishëm, meqë vajzat e reja që janë eksportuar i referohen Mama-Loas gjatë dhe pas procesit të migrimit në Evropë. Do t'i dërgohen para, për të paguar borxhet për organizimin, ose për familjarët e vajzës që ka nisur para.

Zakonisht, vajzat bien në kurth me propozime pune, ose u ofrohet atyre mundësia për të studiuar në Evropë, shpeshherë me prespektivën për të zënë një vend pune si gra shërbimi. Në rastet e tjera, është e dukshme që puna përfshin format seksuale. Trafikantët u kërkojnë para grave për të organizuar udhëtimin e tyre, e meqë këto nuk kanë, firmosin një kontratë më të cilën angazhohen të punojnë në Evropë si gra shërbimi. Në fakt, për shkak të borxheve dhe kërcënimeve që u drejtohen familjeve të tyre, këto gra janë të detyruara të prostituohen. Edhe pse sistemi i trafikimit bazohet mbi mashtrimin dhe bashkëushtimin, nigerianet vijnë gjithmonë e më tepër të eksportuara dhe të hyjnë në xhiron e prostituimit. Prostituimi jashtë shtetit është bërë në fakt një alternativë për nigerianët që jetojnë në mjerim.



tika tjetër që u përket Nigerianeve është lidhja e fortë që, në fazat mes grave që pranojnë propozimin që u bëhet atyre dhe trafikantët : "kontratat" rituale ose mbi betimet e llojit vudù. Betimet zhvillohen ë shenjta të Benin City ose në vende të tjera, ku gratë duhet të lenë objektet e tjera vetjake. Këto lidhje bashkë me frikën konkrete të përdhunimi, dhuna dhe rrahjet) bëjnë që t'i mbajnë gratë në kushte

Tri nivelet e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit

- Niveli i parë është paraqitur nga organizata e përqëndruar mbi *Mama - Loa* në Nigeri, e përbërë nga pjestarë që organizojnë emigrimin e grave dhe që i detyrojnë të prostituojnë nëpërmjet kërcënimeve drejtuar familjeve të këtyre (ose me para të ofruar familjarëve për t'i blerë dhe për t'i përdorur ato). Një pjesë e madhe e përfitimeve u shkon pikërisht atyre.
- *Maman* nigeriane paraqet një nivel tjetër në vendin e destinacionit. Ajo mbledh përfitimet, pagat e tutorëve vendorë, dhe e dërgon pjesën më të madhe të parave koleges së saj në Afrikë.
- Ai që transferon paratë e grave të "eksportuara" familjeve në Nigeri përbën një nivel të tretë. Fitimet e organizatës financohen për një rrjet financiar kriminal, për trafikun e drogës, për trafikimin dhe për pastrimin e parave.

Suksesi i jashtëm

Edhe suksesi jashtë shtetit përbën një element thirrjeje; është fenomeni i ashtuquajturit "*Italos*". Termi i referohet një grupi të veçantë të grave që janë kthyer në Nigeri që janë pasuruar duke punuar si prostituta në Itali. Këto kanë një mënyrë jetese më të lartë në krahasim me njerëzit e vendit dhe u japin shembuj të rejave të vendit se si është e mundur të kesh sukses jashtë shtetit. Disa "*italos*" kanë si detyrë të fusin në kurth vajzat e reja, ose kanë detyrën e *Mama -Loas*.

² Marku A. Gramehna, Coordinator of the Trafficking Task Force, International Organization for Migration – International Conference on New Frontiers of Crime: trafficking in Human Beings and New Forms of Slavery: Verona: 22-23 October 1999

c- Ja historia e një vajze të shitur për një shumë për të blerë një televizor.

Kur Ngun Chai ka shitur vajzën e saj 13-vjeçare në xhiron e prostitucionit për shumën e një televizori, është penduar vetëm se nuk ju ka marr para aq sa duhej për shkëmbimin.

Pastaj Chai, mamaja, ka zbuluar që ajo, fëmija i saj i parë, nuk punonte – ashtu siç i kishin premtuar personat që e kishin blerë – në një qytet afër. Në të vërtetë vajza e saj ishte e detyruar të shiste trupin e saj në një shtëpi publike të Bangkokut, duke pasur tetë klientë në ditë (shumë nga ata turistë seksual të ardhur nga Amerika, nga Anglia dhe nga Australia). Chai ka qarë.

Por lotët nuk ishin për vajzën e saj. "*Duhet ka kisha shitur për 10.000 baht (159 sterlina)*" ka thënë gruaja, dhe jo për 5000 baht (79 sterlina). Ai person na ka mashtruar.

Thai jetojnë në një ndërtesë me çati të bërë me kashtë në fshatin Pa Tek, në periferi të Mae Sai, një qytezë e gjallëruar në veri të Tailandës, në kufi më shtetin ushtarak të Myanmar, që një herë e një kohë njihej si Birmania.

Këtu ka shumë tension ndërmjet ushtrive armike edhe herë pas here plumbat fluturojnë nga njëra anë në anën tjetër të lumit të ujërave të turbullta të Mae Sai. Megjithatë, shpërthimet sporadike armiqësore nuk kanë penguar dy aktivitetet ekonomike kryesore të qytetit që janë: trafikimi i drogës dhe i vajzave.

Sipas Fondit për Fëmijë të Kombeve të Bashkuara, në Azinë juglindore një e treta e vajzave që punojnë në tregun e seksit përfshin moshat nga 12 – 17 vjeç. Shumë prej tyre blihen dhe shiten nga Mae Sai (Scotland On Sunday, në 6 janar 2002.)

d- Ja historia e disa vajzave shqiptare

Në një fshat të vogël dhe të varfër të Fusharrëz, në Shqipërinë e veriut janë duke u zhdukur vajzat. Vajza adoleshente e Fran Bëçakut, Valentina është zhdukur nga shtëpia para një viti dhe nuk dihet më asgjë për të.

Gjin Lleshi ka humbur dy vajza – 15 vjeç dhe 17 vjeç. Thotë se i kanë marrë dy burra që u kishin premtuar se do të martoheshin me to. Ndërkohë, vajzat janë gjetur duke punuar si prostituta adoleshente nëpër rrugët italiane, pasi kanë hyrë ilegalisht nga mafja shqiptare. Kjo gjë ndodh pothuajse çdo ditë në fshatrat dhe qytetet shqiptare. Lydia Bici, e Komisionit Ndërkombëtar Katolik të Migracionit ka thënë: "*Për më tepër, minorenët rrëmbehen në diskoteka, në bare, dhe në shkolla*". Në disa fshatra familjet kanë pushuar së çuari në shkollë vajzat e tyre nga frika se mos ua rrëmbejnë dhe i fusin në një botë që s'mund as ta imagjinojnë.

"*Pjesa më e madhe e viktimave të trafikimit janë më pak se 18 vjeç*" thotë Sophia Mosko e Save the Children. "*Tregu i seksit ka nevojë për vajza gjithmonë e më të reja sepse ka më pak mundësi që të jenë me SIDA*". Për momentin 30.000 vajza shqiptare punojnë nëpër rrugët evropiane. Në një vend që ka rreth 3.000.000 njerëz, do të thotë gati 1% e popullsisë shqiptare. Mendohet që, për pjesën më të madhe, këto prostituta janë futur në Evropë kur ishin fëmijë.

Dy vjet më parë, Mariana Lleshi një vajzë 15 vjeçare u bind që të braktiste shtëpinë e saj, nga një tregtar që i kishte thënë se do ta çonte në Itali për t'u martuar me të. Për tri javë, prindërit e saj nuk kanë pasur asnjë lajm. Pastaj kanë marrë një letër të tmerrshme, Mariana tregonte se kishte çuar në fillim në qytetin Shkodrës, në veri të Shqipërisë, ku ai burri i kishte thënë se nuk do të martohej me të. Në të vërtetë, donte ta shiste si prostitutë. Mariana kishte tentuar të lirohej, dhe ai, e kishte kërcënuar me një thikë, dhe e kishte detyruar vajzën të shkonte me të. Si pjesa më e madhe e prostitutave që janë larguar ilegalisht, Mariana ishte dërguar në qytetin detar në Vlorë, epiqendra e kontrabandës, në pjesën jugore të Shqipërisë. Kalimi i Adriatikut prej atej është vetëm 70 milje: një distancë që trafikantët mund ta bëjnë në më pak se dy orë, me barka të shpejtësisë së madhe. Sipas policisë shqiptare, këto rrëmbyes transportonin më shumë se 40 persona çdo herë.

Kur arrijnë në Itali, vajzat u shiten një tutori. Çmimi caktohet në bazë të moshës së tyre, bukurisë dhe përvojës. "Një vajzë e re dhe e virgjër, e sapo ardhur në Itali, mund të vlejë edhe 10.000 dollarë" – ka thënë Degan Ali, i Organizatës Ndërkombëtare për Emigrimin – "dhe është vërtet një investim". Një ish prostitutë, e rrëmbyer në moshën 17 vjeçe, tregon se çdo natë fitonte pothuajse 500 dollarë, dhe tutori i saj ia merrte të gjitha lekët që fitonte. Një natë, ai zbuloi që ajo fshihte lekë në të brendshmet e saj dhe pasi e drogoi ai e rrahu deri sa humbi ndjenjat.

Mariana ishte futur në kurth në Itali, dhe një tragjedi tjetër e ka goditur familjen Lleshi: edhe motra 17 vjeçare është rrëmbyer. Por këtë herë motra e tretë, Marta ka denancuar përgjegjësit në polici. Pas pak – thotë babai i saj – Marta ishte vrarë barbarisht. Trupi i vajzës i pa jetë ishte gjetur në një thes në anë të një lumi. Vrasësit e saj nuk u gjetën kurrë. (ABCNEWS.com, 12 maj 2002).

e- **Ja historia e Bertës**

Berta është nga Sapele, një qytet në shtetin Delta, në kufi me Edon, ku jeton me motrën e saj. "Jeta është e vështirë në Sapele" thotë Berta. Kush arrin të fitojë 5.000 Naira (50 dollarë) konsiderohet i pasur. Berta është një parukiere, por i duhej akoma që të përfundonte kursin dhe i duhen lekë. Kështu një i njohur, Onome, i propozon të shkojë të punojë për motrën e tij, që është pronare e një parukerie në Gjermani, vajza është e interesuar. Në këtë mënyrë, mund të fitonte paratë e domosdoshme që nevojiteshin për të marrë diplomën e parukerisë. Edhe motra e Bertës e këshillon ta pranojë ofertën. Atëherë Onome i dha një fletë me një adresë në Ikeja, një lagje e Lagos, dhe i thotë të kërkojë një Volvo. Berta arrin me autobus në Lagos, e shoqëruar nga dy vajza të tjera dhe e gjejnë Volvon.



Të tri vajzat e reja nuk e njihnin burrin që ishte në timonin e makinës. Ai i çoi menjëherë në Ghana, duke përfituar nga liria e lëvizjes së garantuar nga një marrëveshje me Komunitetin Ekonomik të Shtetit të Afrikës Lindore (ECOWAS). Arrijnë në Akra në mesnatë, dhe u paraqitet atyre "Zoti Shanti", që i merr në mbrojtjen e tij. Zoti Shanti bën pasaportën për Bertën. Ajo nuk e kishte parë kurrë, por beson se është një pasaportë e vërtetë, me fotografinë e saj. Flenë në Akër, më pas Berta ndahet nga dy vajzat e tjera dhe me zotin Shanti arrijnë në Abidjan, kryeqyteti i Bregut të Fildishtë (Costa d'Avorio). Zoti Shanti i thotë që të bëjë sikur është vajza e tij dhe vihen në udhëtim për në Evropë. Në kufirin Charles de Gaulle, në Paris, kalojnë kontrollet e policisë për imigrimin, që zakonisht dyshon tek personat me ngjyrë.

Është udhëtimi i parë jashtë shtetit për Bertën, që beson akoma se është drejtuar për në Gjermani. Pasi ndryshoi avionin, Berta dhe Zoti Shanti arrijnë në Milano. Vetëm atëherë e reja kupton se gjendet në një shtet tjetër. "Milano është në Itali, jo në Gjermani". Zoti Shanti i thotë se duhet të takojnë dikë, dhe më pas do të vazhdojnë për në Gjermani. Sigurisht që ishte një gënjeshtër. Arrijnë në Firence në tren, ku i pret motra e Onomes. Në fjalorin e trafikimit, ajo është një Madam, domethënë një ish prostitutë që u ka paguar borxhin trafikantëve dhe tani bën tutoren. "Mirëserdhe në Itali!" – i thotë Bertës motra e Onomes. Por vajza ngul këmbë se do të shkojë në Gjermani. Por "gruaja e madhe" (kështu e quan Berta Madamën e saj), është një njeri i ashpër, dhe i thotë se duhet të prostituohet në rrugë. Vajza merr rroba të prera shkurt – pantallona shumë të shkurtër dhe të tejdukshëm, dhe një palë sytjena të tejdukshme – dhe i thonë që të fillojë punën. Berta refuzon, dhe kështu sistemohet në shtëpinë e një të njohuri, dhe fillon "beteja". Situata është e tmerrshme: një grua 23-vjeçare e vetme, në Evropë për herë të parë, pa asnjë dokument, me jetlag dhe pa asnjë rrobë të përshtatshme për dimrin evropian (askush nuk e kishte lajmëruar). Në shtëpi janë rreth njëzetë vajza nigeriane në gjendje të ndryshme emotive. "Disa ishin të terrorizuara" – thotë Berta – "disa të tjera të shqetësuara dhe sillleshin si të çmendura". A ke folur ndonjëherë me to? "Jo, nuk më interesonte të dija se çfarë bënin, dhe nuk doja të dija sa fitonin".

Për tetë ditë motra e Onomes u mundua ta detyronte Bertën që të prostituohet, dhe për tetë ditë ajo ka refuzuar me këmbëngulje. Një vajzë tjetër, që jetonte në shtëpi dhe që shiste bluza, i ka treguar Bertës një grup të Firences të cilit të mund t'i kërkonte ndihmë dhe e ka shoqëruar tek ata persona. E lirë nga Madama e saj, Berta, qëndroi për një muaj tek ndihmësit e saj; më pas u kthye në Lagos së bashku me një vajzë tjetër që do ta quajmë Sonia, me një biletë të ofruar nga Organizata Ndërkombëtare për Imigrimin (OIM).

Aventura e Bertës nuk mbaroi me largimin e saj. Kur u kthyen nga Italia, Sonia dhe Berta njohën Motër Rexhinën, një murgeshë katolike, dhe Bisi Olateru-Olagbebi, e Komitetit Nigerian të Grave (WOCON). Ato ishin duke pritur dy vajzat në aeroportin e Lagos, kur morën vesh se kishte persona të tjerë që po prisnin Bertën dhe Sonian. Në fakt, dy gratë panë një burrë dhe një grua që të dyshuar i afroreshin Bertës dhe Sonias. Motër Rexhina dhe Bisi Olateru-Olagbebi shkuan menjëherë atje dhe, duke u prezantuar i larguan prej andej dy personat, që patjetër bënin pjesë në xhiron e trafikimit; më pas morën vajzat në mbrojtjen e tyre dhe i çuan me makinë në një shtëpi të mbrojtur. Trafikantët i ndoqën deri në orën katër të mëngjesit, dhe

më pas u tërhoqën. Nuk di se si ishin vënë në dijeni të mbërritjes së Bertës dhe Sonias, dhe ky fakt ishte shumë shqetësues për të dyja vajzat dhe për ndihmëset e tyre. Sonia ishte kaq shumë e terrorizuar sa që papritmas u zhduk. Mendohej se mos ishte grabitur, ose edhe vrarë, por më pas u duk shëndoshë e mirë.

Berta vendosi të kthehej në Sapele, dhe tani jeton atje në dritën e diellit. Onome, njeriu që i kishte bërë kurthin Bertës, ishte njëri prej personave të parë që shkoi të takonte Bertën. Motra e tmerrshme e Onomes, që ishte munduar ta vinte të prostituohet, kishte lajmëruar vëllain e saj për kthimin e vajzës, dhe Onome kërkonte shpjegime. *"I thashë se refuzova të punoja në rrugë ashtu siç më ishte kërkuar"*. Tani në Sapele, Berta dhe Onome sillen me njëra-tjetrën me shumë kujdes. Onome e di që Berta mund ta denoncojë dhe të tregojë mbi xhiron e trafikimit. Vajza mund të ishte një dëshmitare kyçe për një ndjekje penale. Por Berta nuk është akoma gati për këtë, sepse duhen muaj, dhe një gjë e tillë mund të krijonte kërcënime të çdo lloji.

Pyetje mbi laboratorin

1. Duke reflektuar mbi historitë e viktimave të trafikut, çfarë keni ndier?
2. Çfarë keni mësuar mbi trafikimin? Kë përfshin? Çfarë ndodh? Kur? Ku? Si mund të ndodhë një gjë e tillë?
3. Shkruani një përcaktim tuajin mbi trafikimin duke u nisur nga fjalia: *Trafiku i grave dhe i fëmijëve do të thotë...*
4. Krahasoni përcaktimet e juaja dhe nxirrni një përcaktim të vetëm
5. Tani lexoni përcaktimin që ndjek mëposhtë, të dhënë nga Kombet e Bashkuara, dhe shënoni se cilat elemente keni përfshirë në përcaktimin tuaj dhe se cilat mungojnë.
6. Çfarë keni mësuar nga ky krahasim?

Çfarë është trafikimi?



Përcaktimi i trafikimit të njohur ndërkombëtarisht gjendet në Protokollin e Kombeve të Bashkuara për të parandaluar, shtypur dhe luftuar trafikimin e personave, dhe mbi të gjitha të grave dhe fëmijëve, si shtesë e Konventës kundër krimit të organizuar transkombëtar, ku është shkruar:

a- "Trafikimi i njerëzve" përfshin futjen, transportin, transferimentin, të strehuarit ose pritjen e personave, nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës ose të formave të tjera të bashkëushtimit, rrëmbimit, mashtrimit, abuzimit të pushtetit ose të një gjendjeje vulnerabiliteti, nëpërmjet të të dhënit ose të marrit të një pagese ose të mira për të patur lejen e personave që kanë kontrollin mbi personat e tjerë, për qëllime shfrytëzimi.

Me shfrytëzim kuptohet, si minimum, shfrytëzimi i prostituimit, ose të formave të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e rënda, skllavëria, ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, të qenit shërbëtorë.

b- Leja e një viktime të trafikimit të personave ndaj shfrytëzimit, sipas mënyrave të ekspozuara në paragrafin e mëposhtëm (a) të këtij artikulli, është i parëndësishëm se ku është bërë njëri prej mjeteve të ekspozuar në paragrafin (a).

c- Reklutimi, transporti, transferimi, strehimi ose të marrit e një të mituri për qëllime shfrytëzimi konsiderohet "trafikim personash" edhe pse nuk kërkojnë asnjë mjet të ekspozuar në paragrafin (a) të këtij artikulli.

d- Për "minoren" kuptohet çdo person nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç.


(Artikulli 3)

- Përputhja ndërkombëtare mbi përcaktimin e trafikimit, dhe bashkimi i mjeteve që përputhen me zhvillimin penal, mbrojtja dhe parandalimi që ekzistojnë, mund të shërbejnë si bazë për një legjislacion kombëtar kundër trafikimit dhe për një pakt mes ligjeve të kombeve të ndryshme.
- Personat që janë objekt trafikimi, mbi të gjitha gratë e detyruara që të prostituohen dhe fëmijët të detyruar që të punojnë, nuk konsiderohen krime, por viktima të një krimi.
- Të gjitha viktimat e trafikimit të personave janë të mbrojtur, jo vetëm ato që mund të provojnë se janë detyruar (Artikulli 3a dhe 3b).
- Përcaktimi garanton se viktima nuk duhet të mbështesë detyrën e provës (Artikulli 3b).
- Përcaktimi furnizon një dorëzim të plotë të mjeteve të veprimit të trafikimit, ku përfshihen jo vetëm ato të forcës, të bashkëushtimit, rrëmbimit, futjes në kurth ose abuzimit të pushtetit, por edhe mjetet më pak të qarta si abuzimi i vulnerabilitetit të viktimës (Artikulli 3a).
- Shfrytëzimi i prostituimit dhe trafikimi nuk mund të ndahen nga njëri-tjetri. Protokollin pranon që një pjesë e madhe e trafikimit ka si qëllim prostituimin ose format e tjera të shfrytëzimit seksual (Artikulli 3a).
- Nuk është e nevojshme që viktima të kalojë një kufi. Janë të mbrojtura edhe gratë dhe fëmijët që janë objekt i trafikimit në brendësi të vendit të tyre për prostituimin ose punën e rëndë në atdhe.
- Elementi kyç i trafikimit është qëllimi i shfrytëzimit, jo zhvendosja nga një vend në tjetrin. (Artikulli 3a).
- Protokollin është strumenti i parë i Kombeve të Bashkuara që i drejtohet kërkesës që është shkak i trajtimit të grave dhe fëmijëve, dhe i bën thirrje të gjitha kombeve derisa të marrin masa, legjislative dhe në fusha të tjera, ose t'i forcojnë, për të dekurajuar këtë kërkesë që ushqen të gjitha format e shfrytëzimit të grave dhe fëmijëve (Artikulli 9.5).

Pyetje për laboratorin

1. Çfarë keni ndier duke lexuar përcaktimin e trafikimit të dhënë nga Kombet e Bashkuara?
2. Cilat lloj kushtesh lejojnë trafikimin?
3. Lidhja mes trafikimit dhe prostituimit është konsideruar gjithmonë e rëndësishme: cilat janë ngatërresat e kësaj lidhjeje?
4. Pse viktimat e trafikimit mund të trajtohen si kriminelë? Kush janë kriminelët e vërtetë?
5. Sipas jush, pse autoritetet e tjera kaq qenë kaq të ngadalta në marrjen e masave kundër atyre që janë përfshirë në trafikim?
6. Çfarë keni mësuar nga ky ballafaqim?

³ Janice G. Raymond, Guide to the New UN Trafficking Protocol. Protocol to prevent, suppress and punish trafficking, especially women and children, supplementing the United Nations Convention Against Transnational Organized Crime, Coalitions Against Trafficking in Women, North Amherst, 2001, 4-5.



Kush është objekti i trafikimit?

- Gratë dhe fëmijët janë objektivi kryesor për shkak të mënjanimit të tyre, të burimeve ekonomike të kufizuara dhe të qenit të tyre në sektorët jo të rregullt "të padukshëm".
- Njerzit që vijnë nga familje të varfëra ose me të ardhura të ulëta, në zonat rurale ose në zonat më fundërrina të qytetit, sidomos gratë e angazhuara në bujqësi të vogla, në tregti të vogla, në shitje, si pastuese, dhe në punë të tjera e shërbime të nivelit të ulët.
- Pakicat etnike, njerëzit vendas, fiset e malësisë, të mërguarit, dhe ata klandestinë.
- Analfabetët, njerëzit me nivel të ulët arsimor, ata që kanë frekuentuar ndonjë vit të shkollës elementare.
- Adolehentet e larguara nga shtëpia, ose vajzat nga të cilat familja e tyre pret të ardhura ekonomike.
- Personat që nuk njohin të drejtat e tyre të njohura nga ligji, që nuk e vënë re se janë në kushtet e shfrytëzimit, dhe që nuk kanë mjete për të patur një dëmshpërblim.
- Gratë dhe fëmijët e moshave të ndryshme, nga fëmijëria deri në pleqëri madje deri edhe në moshën shtatëdhjetë vjeç (për gratë)

Për çfarë shërbejnë viktimat e trafikimit?

Për qëllime të ndryshme: pjesa më e madhe e viktimave të trafikimit janë të angazhuara për prostitucion; pjesa tjetër, në industrinë e spektakleve, në ndërmarrjet që shfrytëzojnë punëtorët, në adoptimet e paligjshme të fëmijëve, në transplantimin e organeve, në martesat e detyruara, në shitjen e nuseve me korrespondencë, në punët e detyruara (në ndërtim, p.sh), në trafikimin e drogës, lypës dhe në forma të tjera punësimi të shfrytëzimit

Çfarë pritet?

Premtimi për të fituar dhe përmirësuar gjendjen e tyre ekonomike, të ndihmojnë ekonomikisht prindërit dhe familjet në fshat, të larguarit nga situatat e konfliktit.

Kushtet e punës

Kushtet e mjerimit; kushtet fizike janë shpesh poshtë standarteve të pranuar; kushtet e punës dhe të trajtimit shpesh përbëjnë një situatë të fillë në skllavëri ose në burgosje: orare të zgjatura pune, pak pushim dhe pak zbavitje, rroga të ulëta ose që nuk ekzistojnë; punëtorët i shohin rrallë fitimet e tyre që mbahen nga trafikantët dhe nga punëdhënësit e tyre; të qenit në borxh për një kohë të gjatë me trafikantët, me punëdhënësit, me pronarët e shtëpive publike, dhe injoranca e klauzolave të borxhit; të ekspozuarit në punë të rrezikshme; pothuajse nuk marrin shërbim mjekësor e shëndetësor; abuzime fizike dhe seksuale në rendin e ditës.

⁴ Taken from UNIFEM East and South-East Asia, Trafficking in Women and Children. Mekong Sub-Region.

Efektet e dëmshme mbi gratë dhe fëmijët

(afatgjatë dhe afatshkurtër)

- **Shëndeti:** gratë dhe vajzat rrezikojnë vazhdimisht të mbeten shtatëzënë, të vdesin për shkak të lindjes, në marrjen e sëmundjeve seksuale të përcjellura si HIV / AIDS.
- **Droga dhe varës të tjerë:** keqësim fizik dhe mendor.
- **Kërcënim i shëndetit emotiv:** frika e qëndrueshme e arrestimeve, e izolimit, e privimit të familjarëve dhe e sistemeve të ndihmës sociale; përruljet dhe abuzimet shkaktojnë plagë emotive dhe shkaktojnë pasoja psikologjike.
- **Kërcënimi sigurisë fizike:** e caktuar nga njerëz pa skrupuj, nga policia, nga funksionarët doganalë, nga punëdhënësit dhe personat e tjerë.
- **Kapja nga ana e autoriteteve:** burgosje, procese gjyqësore, dëbim me forcë.
- **Vështirësi në integrimin social për ato që kthehen në bashkësitë e tyre.**
- **Skllavëri ekonomike:** gratë duhet të paguajnë shumat e kërkuara nga trafikantët për udhëtimin dhe dokumentat.

Pyetje për laboratorin

1. Trafikimi i grave dhe i fëmijëve konsiderohet një dhunim i të drejtave njerëzore në vendin tuaj?
2. Cila është natyra e problemit në vendin tuaj? Kush është objekti i trafikimit? Pse?
3. Çfarë lidhje ka mes trafikimit dhe prostituimit?
4. Ente të tjera ndërqeveritare dhe organizata të tjera kanë dhënë një përcaktim të grave dhe fëmijëve. A mund të dalloni dhe bëni një kritikë të këtyre përcaktimeve?
5. Zbuloni nëse vendi juaj ka nënshkruar dhe ratifikuar Protokollin e Kombeve të Bashkuara mbi trafikimin e grave dhe fëmijëve:
 - Nëse e ka nënshkruar, cili legjislaçion i ri është futur, dhe si është zbatuar?
 - Nëse nuk e kanë nënshkruar, për çfarë arsye? Çfarë mund të bëni për të ndryshuar gjendjen?
6. Çfarë janë duke bërë për të parandaluar trafikimin në vendin tuaj? Disa propozojnë që të legalizohet prostitucioni. A jeni dakort?

Hapësira e problemit

Ky seksion përshkruan zgjerimin e problemit në nivel ndërkombëtar. Shkaqet do të analizohen më tej, në seksionin e verdhë. Pasi të kenë studiuar seksionin e verdhë, jeni të ftuar të analizoni dhe hetoni problemin e trafikimit në vendin ose krahinën tuaj.

"Trafikimi i personave" sot i përket secilit komb. Gratë dhe fëmijët janë viktimat kryesorë dhe trafikohen për shfrytëzimin seksual. Është një ndër aktivitetet kriminele që rritet në mënyrë të shpejtë, pas drogës dhe armëve. Me natyrën klandestine të fenomenit, është e vështirë të bësh statistika, por kemi disa të dhëna të sigurta.

- Çdo vit trafikohen nga 70.000 deri në 2.000.000 persona.
- Pjesa më e madhe e viktimave vjen nga Azia (më shumë se 225.000 viktima çdo vit nga jug-perëndimi aziatik, dhe më shumë se 150.000 nga Azia e Jugut).
- Ish Bashkimi Sovjetik duket sikur është kthyer burimi më i madh, me më shumë 100.000 persona të trafikuar për prostitucion ose për shfrytëzimin seksual.
- 75.000 ose më shumë trafikohen nga Evropa e perëndimit.⁵
- Nga 200.000 në 500.000 gra trafikohen nga Amerika latine në Shtetet e Bashkuara dhe në Evropë çdo vit.
- 50.000 të tjera vijnë nga Afrika.

Hapësira e problemit mund të kuptohet duke ekzaminuar të dhënat e mëposhtme.

Azia e Jugut

Nga Bangladeshi, eksportohen çdo vit 25.000 persona. Në mars të 2001 është referuar se, prej këtyre, nga 10.000 në 15.000 trafikohen çdo vit në Indi. 4.500 të tjerë eksportohen në Pakistan, dhe mbetja në Lindjen e Mesme⁷. Nga 74 milionë gra të Azisë së Jugut të zhdukura, duket se 20 milionë janë kthyer skllave në shtëpitë publike indiane. Dimë se 25% e tyre janë të mitura.

Gratë nepaleze dhe ato të lindura në Bangladesh gjenden kryesisht në metropolin e Delhit të Ri, Mumbai dhe Kolkata.⁸ Mes 100.000 dhe 200.000 grave dhe vajzave nepaleze, janë trafikuar në Indinë qendrore dhe veriore, në Azinë e Jugut dhe në Lindjen e Mesme. Raportet referojnë se çdo vit trafikohen në Indi nga 5.000 deri në 7.000 gra dhe vajza nepaleze. Pakistani është një nga vendet kryesore të vendmbërritjes së personave të eksportuara nga Bangladeshi. Mendohet se, vetëm në 10 vitet e fundit, pothuajse 200.000 gra (nga moshë 12 deri në 30 vjeç) janë trafikuar aty.

Në Pakistan, ata që kërkojnë strehim politik dhe refugjatët (veçanërisht gratë dhe fëmijët) janë pre e lehtë e trafikantëve, dhe çdo muaj rrëmbehen nga 200 deri në 400 emigratë, madje edhe më tepër. ECPAT (i vë fundin prostituimit fëmijor, pornografisë dhe trafikimit) tregon se në Pakistan 20.000 fëmijë janë të përfshirë në xhiron e prostituimit.

Sri Lanka është një nga vendet e preferuara të turizmit seksual dhe konsiderohet "parajsa e pedofilëve". Deri në 10.000 fëmijë, të moshës prej 6 deri në 14 vjeç, trafikohen në brendësi të vendit dhe janë kthyer skllavë në shtëpitë publike të Sri Lankës.¹⁰ Nga gratë e eksportuara, 17.000 janë prostituta në Kuvait.¹¹

Caritas-i i Sri Lankës referon se rreth gjysmës së viteve '90, rreth 45.000 gra janë emigruar në vendet e Azisë Perëndimore.¹²



⁵ Francis T. Miko and Grace Park, *Trafficking in Women and Children: The U.S. and the International Response*, Congressional Research Service Report 98-649 C, May 10, 2000 (Gjendet në <http://usinfo.state.gov/topical/global/traffic/crs0510.htm>, 16.07.02).

⁶ "Landmark Judgement on Bangladeshi Women Trafficking to India", *AP World News*, May 9, 2001.

⁷ The Protection Project, 2002 Human Rights Report On Trafficking In Persons, Especially Women And Children. A Country-by-Country Report on a Contemporary Form of Slavery (Gjendet në <http://www.protectionproject.org/main1.htm>, 24.07.02).

⁸ Ivi.

⁹ Ivi.

¹⁰ See "Landmark Judgement", *AP World News*, May 9, 2001

¹¹ The Protection Project, 2002 *Human Rights Report*.

¹² A. Kathleen, Some Observations from Sri Lanka, Caritas Sri Lanka, October 1999 (unpublished paper).

Azia juglindore

Llogariten se 30.000 gra kamboxhiane janë eksportuar dhe futur në punë të rëndomta në vendet aziatike të afërta, sidomos në Tailandë, në Malejzi dhe në Taivan.¹³ Në Kamboxhia janë përreth 50.000 dhe 55.000 persona që punojnë në xhiron e seksit. 40% janë gra vietname dhe mbetja tjetër janë gra dhe vajza të rrëmbyera nga zonat rurale.¹⁴ Kongresi Botëror Kundër Shfrytëzimit Seksual Tregtar të Fëmijëve referon se pothuajse 20.000 fëmijë janë përfshirë në xhiron e prostituimit në Kamboxhia.

Qeveria e Lao PDR tregon se më shumë se 15.000 të reja nga provinca e Savannakhet kanë kërkuar punë në Tailandë.

Nga 20.000 në 30.000 gra dhe vajza janë eksportuar veçanërisht në shtëpitë publike në Tailandë. Nga janari deri në qershor të 2001 janë arrestuar dhe dëbuar më shumë se 92.000 imigrantë klandestinë birmanë.¹⁷

Sipas organizatës jo qeveritare filipine Gabriela, në Filipine janë rreth 600.000 prostituta. Rreth 50.000 e 6.000 fëmijë janë përfshirë në xhiron e prostituimit. Raportet e tjera referojnë se gratë filipine të angazhuara jashtë shtetit janë për 60-80%, që i kushtohen punëve shtëpiake dhe lokaleve të natës. Në dhjetë muajt e parë të 1998, 640.054 filipinase (3.5% më shumë se në vitin e mëparshëm) kanë lënë vendin për të punuar jashtë shtetit. Shumë prej tyre nuk janë të regjistruara, kështu që është e vështirë të vlerësohet se sa kanë qenë viktimat e trafikimit. Llogaritet se në Korenë e Jugut janë 80.000 punëtorë filipinas të parregullt më tepër se 130.000 të regjistruar. Në Japoni ku gratë filipinase përfundojnë në rolin e grave që zbavisin në lokalet e natës, 35.200 janë punonjëse të paligjshme.¹⁸

Sipas UNICEF-it, në Indonezi mes 40.000 dhe 70.000 të rinj, sidomos fëmijë, janë përfshirë në xhiron e prostitucionit fëmimor. Gratë indoneziane trafikohen në vende të ndryshme. Të dhënat flasin për 58.000 imigrantë në Hong Kong dhe për 4.600 prostituta në Malejzi.

Tailanda është burimi, vendi tranzit, dhe i mbërritjes së prostitutave. Sipas një Organizate Ndërkombëtare të Punës (ILO), çdo vit 200/300.000 gra trafikohen në Tailandë. Ato vijnë nga Kamboxhia, nga Myanmar, nga Lao PDR, dhe nga vende të tjera. Të dhënat e qeverisë tajlandeze mbi trafikimin flasin për 60.000 fëmijë të shitur për prostitucion. Një raport tjetër tregon se nga 100.000 në 200.000 gra tajlandeze punojnë jashtë shtetit në shtëpitë publike dhe në lokalet e natës.¹⁹

Të dhënat mbi Vietnamin tregojnë se që nga 1991 pothuajse 10.400 gra u janë shitur burrave kinezë si nuse që porositen për postë. Shumë prej këtyre janë detyruar të prostituohen. Koalicioni Kundër Trafikimit të grave (Azia e Paqësorit) tregon se mes 60.000 dhe 200.000, 6,3% e të cilave janë më pak se 16 vjeç.



¹³ The Protection Project, 2002 Human Rights Report.

¹⁴ Sofiani Subki, "Helping sex slaves". In Asia Intelligence Wire, July 18, 2002

¹⁵ The Protection Project, 2002 Human Rights Report.

¹⁶ UNIFEM East and South-East Asia, Trafficking in Women and Children, Mekong Sub-region, 23 September 1998 (Gjendet në <http://www.unifem-eseasia.org/Resource/traffick2.html>, 30.07.02).

¹⁷ Ivi.

¹⁸ Gabriela, "Stop Sex Trafficking of Filipino Women and Children!", June 1999 (Gjendet në <http://www.unifem-eseasia.org/Resource/traffick2.html>, 30.07.02).

¹⁹ Ivi.

Azia Lindore

Në Japoni, 90% e 150.000 prostitutave është importuar nga vende të ndryshme. Në vitin 2000, Kina i ka dhënë një xhiro jete trafikimit duke liruuar 110.000 gra dhe 13.000 fëmijë. Në Kinë trafikohen shumë gra nuse. Llogaritet se 50.000 gra janë shitur për t'u lidhur në martesë kundër vullnetit të tyre.

Mes të dhënave mbi trafikimin në Korenë e Jugut është më e njohura nga televizioni privat kazaja tregon se pothuajse 2.000 gra kazake që punojnë në industrinë e seksit të Koresë së Jugut. Sipas një llogarie të bërë në prill 2002, në vitin 2000 nga janari në prill në Korenë e Jugut kanë hyrë deri në 6.000 gra ruse.²¹ Në janar të 2002 policia ka arrestuar dhe dënuar anëtarët e një rrjeti vendor të furnizuesve të punës ose të drejtuesve të bareve të koreanëve të jugut. Po në të njëjtin vit, Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (IOM) ka ndihmuar gratë peruiane viktime të trafikimit të gjetura në Korenë e Jugut.

Azia Perëndimore

UAE ka qenë qëllimi i më shumë se 500.000 personave, dhe pjesa më e madhe e grave vjen nga ish Bashkimi Sovjetik pas rënies së 1991. Llogaritet se nga 2.000 në 3.000 gra çohen çdo vit në Izrael. Edhe pse nuk njihet numri i saktë, thuhet se 10.000 gra janë trafikuar në Izrael në dhjetë vitet e fundit, dhe se në vend çdo ditë kanë zënë vend deri 25.000 marrëveshje për qëllime seksuale.²²

Evropa e lindjes

Shërbimi sekret i sigurisë moldave tregon se më shumë se 600.000 qytetarë moldavë punojnë si klandestinë jashtë shtetit. 70.000/80.000 prej këtyre emigrantëve janë gra, ku shumë prej tyre të futura në prostitucion. Llogaritet se trafikohen çdo ditë rreth 50 ose 60 gra për qëllime të shfrytëzimit seksual.²³ Në 1999, organizata jo qeveritare "Rruga", që punon mbi trafikimin, ka komunikuar se në dhjetë vitet e fundit 420.000 gra janë shitur për prostitucionin.²⁴ Çdo muaj, pothuajse 1.000 nisen nga i vetmi qytet Ukrainas për të kërkuar punë jashtë shtetit. Numri i nuseve të shitura për postë është gjithnjë në shtim: pothuajse 2.000 çdo vit.²⁵

"La Strada" tregon se në Poloni ka nga 1.200 deri në 10.000 gra bullgare të detyruara të prostituohen. Ndër të tjera ka gra që janë trafikuar nga vendet e tjera të Evropës së lindjes dhe nga ish Republika Sovjetike. Thuhet se në Poloni rreth 15.000 prostituta vijnë nga jashtë.²⁶

Sipas Grupit për të Drejtat Njerëzore, 10.000 gra bullgare janë të detyruara të prostituohen. 70% e prostitutave të Dubai vjen nga Bullgaria. Çdo vit, 2000 gra lituane trafikohen në vendet e Evropës perëndimore.²⁷ Llogaritet se mes 175.000 dhe 500.000 të reja janë të detyruara të prostituohen në Ballkan.²⁸

²⁰ Ivi

²¹ "Trapped in modern slavery: Sex trafficking turns Russian women into Korean pawns" Ben Jhoty (Gjendet në <http://www.koreaherald.co.kr/SITE/data/html-dir/2001/11/02/200111020003.asp>, 30.07.02).

²² The Protection Project, 2002 Human Rights Report.

²³ Minnesota Advocates for Human Rights, Trafficking in Women: Moldova and Ukraine, Minneapolis, December 2000, 26. (Gjendet në <http://www.mnadvocates.org/publications/Women%20Publications/TraffickingReport.pdf>)

²⁴ Ivi

²⁵ The Protection Project, 2002 Human Rights Report.

²⁶ Ivi

²⁷ Ivi

²⁸ "OCSE Examines Forced Prostitution", Reuters/Central Europe Online, April 27, 2001

Evropa perëndimore

Të gjitha vendet e Evropës perëndimore marrin gra viktime të trafikimit nga e gjithë bota. Llogaritet se çdo vit eksportohen 120.000 gra në vendet e Evropës perëndimore, të ardhura mbi të gjitha nga Evropa qendrore, nga Evropa lindore, dhe nga Federata ruse. Vetëm nga Shqipëria vijnë 30.000 gra që prostituohen në Evropë.²⁹ Pjesa më e madhe e grave që eksportohen nga Afrika, deri në 50.000, vijnë nga Nigeria, dhe punon në rrugët evropiane (mbi të gjitha në Itali, ku duket se janë 30.000 prostituta nigeriane).³⁰ Gratë e tjera dhe të rejtat e tjera afrikane të eksportuara në Evropën perëndimore vijnë nga Ghana, nga Maroku, nga Benin dhe nga Tunizia.

Sipas një zëdhënësi të Kombeve të Bashkuara, deri në 75.000 gra braziliane janë eksportuar në Evropë, mbi të gjitha në Angli, duke kaluar nga Portugalia. Vetëm në Vendet e Ulëta duket sikur ka 5.000 kolumbiane të detyruara të prostituohen. 50% e prostitutave të Amsterdemit, Roterdamit dhe Utrecht vijnë nga Republika Domenikane.³¹ Llogaritet se prostitutat në Spanjë janë 300.000. Pjesa më e madhe janë imigrante klandestine.³²



Afrika

Llogaritet se çdo vit eksportohen më shumë se 50.000 viktime nga Afrika. Siç u tha edhe më sipër, pjesa më e madhe e tyre janë nigeriane (të shihet Evropa). Shërbimi për imigrimin e Ghanës tregon se mes 1998 dhe 2000 janë eksportuar nga vendi 3.582 gra.³³

Në 1999, sipas të dhënave, rreth 12.000 dhe 20.000 gra etiopiane punojnë në kushte të rënda abuzimi si ndihmëse shtëpiake në Liban.³⁴

Të dhënat e paraqitura nga qeveria e Shteteve të Bashkuara tregojnë se, në vitet e fundit, gratë dhe fëmijët e rrëmbyer nga Sudani jugor të dërguar në Sudanin perëndimor dhe verior kanë qenë 14.000.³⁵

Në disa pjesë të Afrikës, trafiku i fëmijëve është bërë një problem shumë i përhapur. Sipas UNICEF-it, në Afrikën qendrore dhe perëndimore trafikohen nga një vend në tjetrin më shumë se 200.000 fëmijë.³⁶ Në Angola, duket se kanë qenë 10.000 fëmijë të pa strehë, shumë prej tyre binden që të prostituohen.³⁷ Një kërkim i drejtuar në vitin 2000 nga qeveria e Zambisë tregon se, në vend, deri në 563.000 fëmijë, të moshës nga 15 deri në 17 vjeç, ishin përfshirë në disa forma pune shtëpiake dhe prostituim.³⁸ Ish Komisar i Lartë për të Drejtat Njerëzore e Kombeve të Bashkuara, Mary Robinson, duke iu referuar qindra fëmijëve të rrëmbyer në Sudan dhe në Uganda nga Ushtria e Lord's Resistance, ka thënë se pjesa më e madhe e 6.000 fëmijëve të zhdukur angazhoheshin si luftëtarë, si hamallë ose si sklevër seksualë të rebelëve.³⁹

Në Guinen ekuatoriale, janë trafikuar nga Benin, nga Burkina Faso, nga Ghana, nga Mali, nga Mauritania, nga Nigeria, dhe nga Togo, pothuajse 18.000 fëmijë të moshës nga 10 deri në 14 vjeç. Llogaritet se në Gambia ka 49.000 fëmijë, të moshës 10 deri në 14 vjeç, ekonomikisht aktivë.⁴⁰

Disa ekspertë tregojnë se nga Amerika Latine eksportohen në Shtetet e Bashkuara dhe në Evropë deri në 200.000/500.000 gra çdo vit.

Në Republikën dominikane prostituohen 50.000 gra, në shërbim të një milion e gjysmë turistëve seksualë që çdo vit arrijnë në vend.⁴¹

²⁹ "Albanian Girls Sold Into Sex Trade", ABCNEWS.com, May 21, 2001

³⁰ TED case studies, *The Trafficking of Nigerian women into Italy*, January 2002 (Gjendet në <http://www.american.edu/TED/italian-trafficking.htm#r1>, 30.07.02)

³¹ The Protection Project, 2002 *Human Rights Report*.

³² "Spanish region draws up pioneer legislation to regulate brothel prostitution" AP World News, Aug 2, 2002.

³³ "New IOM Figures on the Global Scale of Trafficking", Trafficking in Migrants – Quarterly Bulletin, April 2001 (Gjendet në <http://www.iom.int/DOCUMENTS/PUBLICATION/EN/tm-23.pdf>, 30.07.02).

³⁴ Ivi

³⁵ The Protection Project, 2002 *Human Rights Report*

³⁶ *Fact Sheet on Human Trafficking* (Gjendet në <http://www.undcp.org/trafficking-fact-sheet.html>)

³⁷ The Protection Project, 2002 *Human Rights Report*

³⁸ Ivi

³⁹ *Hundreds of Children Will be Sold into Slavery in Africa* (Gjendet në http://ananova.com/news/story/sm_264656.html)

⁴⁰ The Protection Project, 2002 *Human Rights Report*

⁴¹ Ivi

Amerika Latine

Sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migrimin (IOM), pothuajse 70.000 dominikane janë përfshirë në industrinë e seksit jashtë shtetit. Pjesa më e madhe e tyre është e detyruar të prostituohet nga kontrabandistët imigrantë. Trafikantët fusin në kurth gratë me premtimet e tyre për t'u gjetur punë dhe i eksportojnë në mënyrë klandestine në shtetet e tjera, si Spanja, Vendet e Ulëta, Itali, Gjermani, Zvicër, Argjentinë, dhe në vendet afër karaibike.⁴²

Llogaritet se në Brazil ka rreth 100.000 fëmijë që jetojnë dhe punojnë në tokë, shumë prej të cilëve pësojnë shfrytëzime seksuale.⁴³ Ekziston edhe trafikimi: vajzat që jetojnë nëpër baraka janë dërguar në zonat e largëta të minierave të Amazonës, ku shfrytëzohen seksualisht nga minatorët. Në Meksikë, çdo muaj, pothuajse 100.000 fëmijë dhe adoleshentë përfundojnë në rrjetën e prostituimit fëmijor, të drejtuar nga mafja ose nga shoqatat kriminale të organizuara.⁴⁴

Në Kolumbi, llogaritet se trafikohen dhjetë gra çdo ditë dhe se jashtë shtetit janë aktualisht 500.000 gra dhe fëmijë kolumbianë viktima të shfrytëzimit seksual dhe të punës së rëndë. Meqë situata e brendshme rëndohet, gjithnjë e më tepër gratë dhe fëmijët përfshihen në trafikim, sepse mundohen të lenë vendin, në kërkim të kushteve më të mira të jetës.⁴⁵

Sipas llogarive të vonëshme të medias, në Kosta Rika, vetëm në qytetet e San Jose (një nga pikësynimet e turistëve seksualë, mbi të gjitha të mijërave turistëve që vijnë nga Amerika e Veriut),⁴⁶ prostituohen 3.000 gra dhe vajza. Në Venezuelë, më shumë se 40.000 fëmijë janë përfshirë në prostituim. Rreth 24.000 fëmijë janë trafikuar nga Bolivia në Kili të veriut, në Argjentinë dhe në Brazil.

Shtetet e Bashkuara dhe Kanada

Shtetet e Bashkuara janë një nga vendet e mbërritjes së grave dhe fëmijëve të trafikuar për qëllime seksuale që vijnë nga e gjithë bota. Sipas CIA (Shërbimi Sekret Qendror), çdo vit arrijnë në Shtetet e Bashkuara nga 50.000 deri në 100.000 gra viktima të trafikimit. Në dhjetëvitet e fundit, deri në 750.000 gra janë eksportuar në Shtetet e Bashkuara.⁴⁷ UNICEF-i tregon se janë rreth 90.000 dhe 300.000 të mitur që prostitohen në vend.

Llogaritet se në Kanada çdo vit eksportohen pothuajse 16.000 persona, por është e vështirë të vendoset se sa prej këtyre janë detyruar të prostituohen.⁴⁸

⁴² "Trafficking in Women from the Dominican Republic for Sexual Exploitation," *International Organization for Migration*, June 1996. Also "DOMINICAN REPUBLIC-PROSTITUTION IOM denounces force prostitution of Dominican women", *EFE News Service*, 24th September 2002

⁴³ Gruaja M. Hughes, *Factbook on Global Sexual Exploitation*.

⁴⁴ Elena Azola and Diego Cevallos, "Sterile at Age 12, AIDS at 14", *IPS*, 10 February 1998.

⁴⁵ See "News IOM Figures".

⁴⁶ The Protection Project, *2002 Human Rights Report*

⁴⁷ Ivi.

⁴⁸ Ivi

Pyetje mbi laboratorin

1. Pasi keni lexuar këtë seksion mbi përhapjen e problemit, cilat janë reagimet e juaja dhe ndjenjat e juaja?
2. A e njihni situatën e trafikimit të grave dhe fëmijëve në vendin ose krahinën tuaj? Ndodh në nivel vendor dhe/ose ndërkombëtar?
3. A mund të gjeni organizata jo qeveritare (OJQ) dhe organizata të tjera që merren me gratë dhe fëmijët viktime të trafikimit dhe që mund t'ju ndihmojnë të njihni përhapjen e problemit?
4. Cilat janë kushtet ekonomike, sociale, politike dhe kulturore të vendit tuaj ose krahinës që kontribuojnë në shtimin e trafikimit për shfrytëzimin seksual?
5. Shqyrtoni Treguesin dhe vëzhgoni modelet e trafikimit që zhvillohet nëpërmjet, nga, ose drejt shtetit ose krahinës tuaj. Çfarë ju bën më shumë përshtypje nga këto modele?